

JORGO BULO

STUDIMET E SOTME SHQIPTARE MBI NAIM FRASHËRIN*

Historia e studimit shkencor të jetës dhe veprës letrare të Naim Frashërit ka nisur vetëm pas vendosjes së pushtetit popullor në Shqipëri, në kuadrin e politikës kulturore të partisë për njohjen dhe vlerësimin e traditave dhe trashëgimisë letrare-artistike të së kaluarës. Si pjesë e çmuar e këtij trashëgimi vepra e Naimit tërhoqi ndër të parat vëmendjen e studjuesve; studimi i saj shkencor, për vetë rolin që ka luajtur dhe vendin që ajo zë në trashëgiminë kulturore e letrare të popullit tonë, fitonte një rëndësi të përgjithshme që i kalonte caqet e vlerës që kanë në vetvete punime të veçanta për autorë të ndryshëm të letërsisë kombëtare. Detyrat e ndërtimit të shoqërisë së re dhe të kulturës së re socialiste, kërkonin që përmes studimit dhe propagandimit të vlerave ideore dhe artistike të poezisë së Naimit të afirmoheshin edhe parimet e reja të metodologjisë shkencore marksiste mbi bazën e të cilave duhej bërë vlerësimi objektiv shkencor dhe interpretimi kritik i gjithë trashëgimit letrar e kulturor të epokave të kaluara, duke u orientuar nga zbulimi dhe popullarizimi i anëve më pozitive, patriotike e demokratike të këtij trashëgimi. Për plotësimin e kësaj detyre shkenca jonë letrare nuk mund të mbështetej në ato pak studime të së kaluarës qoftë për veprën e Naim Frashërit, qoftë për epokën dhe letërsinë e Rilindjes në tërësi; përkundrazi, asaj i duhej të formohej si shkencë e re marksiste në luftë me konceptet idealiste dhe antishkencore që ishin në bazë të atyre studimeve.

Figura e Naimit në të kaluarën ose ishte shfrytëzuar me demagogji për interesa të caktuara politike, ose ishte lënë në hije e ishte përçmuar, ose ishte ndriçuar nga pozitat e nacionalizmit borgjez, të eklektizmit filozofik dhe të koncepteve subjektivist-idealiste të shkollave estetoformaliste e psikologjike. I takoi shkencës së re shqiptare historiko-letrare që, mbi bazën e metodologjisë marksiste, të nxirrte në dritë të vërtetë figurën dhe veprën e Naim Frashërit dhe t'i jepte asaj vendin e nderit në historinë e zhvillimit të lëvizjes, kulturës dhe letërsisë sonë kombëtare.

Në këtë rrugë studimet tona u ndriçuan nga një varg dokumentash të partisë për problemet e traditës sonë, të cilat ndihmuan të kapërceheshin si disa shfaqje nihiliste sektare ashtu edhe ndikimet idealizuese nacionaliste që vinin nga shkenca e paraqirimit.

*) Kumtesë mbajtur në sesionin shkencor kushtuar 125-vjetorit të lindjes së Naim Frashërit, organizuar nga Lidhja e shkrimtarëve dhe e artistëve të Shqipërisë dhe USHT.

Studimi i veprimtarisë patriotike dhe letrare të Naimit ka kaluar nëpër dy etapa. Ai zuri fill me artikuj e ndonjë punim të veçantë të viteve të para të pasçlirimit që tërhoqën vëmendjen sidomos për rëndësinë aktuale dhe vlerën historike-nacionale të veprës së poetit¹ ose trajtuan ndonjë aspekt të cakuar të saj, siç ishte problemi i veçorive të gjuhës së Naimit.² Studimet e mëvonshme kontribuan për të ndriçuar në plan tërësor veprën e Naimit dhe për të zbuluar vlerën e saj objektive. Kësaj i shërbeu punimi monografik i prof. Dh. S. Shuteriqit, i pari i këtij lloji për Naimin, botuar në revistën «Literatura jonë»³ (1948) si dhe teksti «Historia e letërsisë shqipe të Rilindjes» (për Institutin pedagogjik) ku për herë të parë bëheshin përpjekje për t'i dhënë një vend e interpretim të ri veprës së Naimit në kuadrin e historisë së letërsisë së Rilindjes shqiptare që synonte të ndërtonte ky tekst⁴.

Një nxitje të veçantë studimeve për rilindasit u dha kremtimi gjatë vitit 1950 i jubileut të katër prej figurave më të shquara të kësaj epoke, Naimit, Samiut, Çajupit dhe Kristoforidhit. Në kuadrin e këtij jubileu u bë një punë shumë e gjerë për popullarizimin e rezultateve të para në të cilat kish arritur shkencë jonë në studimin e veprës së poetit⁵ dhe u nxorën në dritë sidomos ato elemente pozitive të cilat duhej të shfrytëzoheshin në luftën për ndërtimin e kulturës së re socialiste. Kërkimet në këtë fushë vijuan mbi një bazë më të organizuar nga seksioni i gjuhës dhe i letërsisë së Institutit të shkencave dhe më vonë nga sektori i historisë së letërsisë shqiptare pranë Institutit të historisë e të gjuhësisë.

Një varg artikujsh e punimesh të studjuesve të ndryshëm bënë objekt studimi vepra e probleme të veçanta, ose trajtuan aspekte të veprimtarisë letrare e patriotike të poetit⁶. Në tërësi studimet e kryera gjatë etapës së parë ndihmuan që të krijoheshin një përfytyrim më i qartë për epokën e Rilindjes dhe vendin e Naimit në të, të ndriçoheshin në mënyrë më të plotë lidhjet e veprës së poetit me lëvizjen patriotike të kohës dhe me pikëpamjet e tij filozofike si dhe roli që lojti ai për zgjimin e vetëdijes kombëtare dhe për themelimin e letërsisë kombëtare e të gjuhës letrare shqipe.

1) Shih: Buda A., *Naim Frashëri* (Në 45-vjetorin e vdekjes së tij) — «Bota e Re», 1945, 5, 50-52; Shtylla B., *Naim Frashëri*. «Literatura jonë», 1947, Nr. 3-4, f. 1-8; etj.

2) Shih: Khuvani A., *Naimi si poet e si prozator*, «Literatura jonë», 1947 Nr. 3-4, f. 9-30.

3) Shih: Shuteriqi Dh. S., *Naim Frashëri* (Me rastin e 48-vjetorit të vdekjes së tij), «Literatura jonë», 1948, Nr. 6-7 [gusht-shtator], f. 18-63.

4) Po ai, *Historia e letërsisë shqipe të Rilindjes* (Dispensë e Institutit Pedagogjik, 1948).

5) Shih: Varfi a., *Naim Frashëri (25.V.1846) — 20.X.1900*, «Letërsia jonë», 1950, Nr. 9, f. 63-71; Musaraj Sh., *Naim Frashëri*, «Letërsia jonë», 1950, 10, f. 33-65; Shuteriqi Dh., *Naim Frashëri* (me rastin e 50-vjetorit të vdekjes), «Zëri i Popullit», 1950, 20 tetor; etj.

6) Shih: Bala V., *Bagëti e bujqësija* (70-vjetori i botimit të «Bagëti e bujqësija» 1886-1956), «Zëri i Popullit», 1956, 5 maj; Bulka N., *Frazeologjia shqipe (lokucionet) në veprën e Naim Frashërit «Historia e Skënderbeut»*, Bul. USHT (Seria Shk. shoq.) 1957, nr. 1 (3), f. 206-224; Demiraj Sh., *Dy fjalë*, Parathënje e librit N.H. Frashëri — «Bagëti e Bujqësia» T. 1956, f. 5-11; Spasse S., *Poema e Naim Frashërit «Historia e Skënderbeut»*, «Nëndori», 1954, 4, f. 115-130; Po ai, *Naim Frashëri, pedagog i çuar i shkollës shqipe*, «Arsimi popullor», 1955, 10, f. 5-8; Shuteriqi Dh. S., *Historia e Skënderbeut*, «Zëri i Popullit», 1954, 26 mars; Po ai, *Bagëti e Bujqësia*, «Nëndori», 1956, 5, f. 102-105; etj.

Rezultatet e arritura gjatë kësaj etape në studimin e veprës së Naimit u sintetizuan në kapitullin përkatës të «Historisë së letërsisë shqipe»⁷ që është vepra më e rëndësishme me karakter përgjithësues historiko-letrar e kryer nga shkenca jonë për letërsinë. Në këtë vepër, me të cilën nis historia e botimeve të kësaj natyre tek ne, studimi i jetës dhe i veprës së Naimit u vu mbi një bazë të shëndoshë metodologjike dhe u realizua si pjesë organike e studimit të procesit historiko-letrar të kohës; duke mënjanuar kësaj empirizmin që kish karakterizuar përgjithësisht punimet e së kaluarës. Figura e Naimit gjeti në këtë vepër vendin e merituar si figura qendrore e Rilindjes dhe një trajtim të gjerë e gjerdiku tërësor si poet i lëvizjes kombëtare, si mendimtar demokrat e nismëtar në disa fusha të krijimit poetik, ai autor që krijoi një traditë të tërë dhe luajti një rol të shquar për zhvillimin e letërsisë e të mendimit përparimtar të kohës.

Kërkimet që u ndërmorën në etapën e dytë zgjeruan dhe thelluan studimin e disa aspekteve të veçanta të veprës së Naimit. Problemit të pikëpamjeve filozofike, shoqërore dhe etike të poetit iu kushtuan disa punime të prof. Z. Xholit të cilat, duke trajtuar këto anë fare pak të studjuara më parë, plotësuan një zbrazëti që ndjehej⁸. Pati gjithashtu edhe gjatë kësaj faze artikuj e punime që, ose prinë botimin e ndonjë prej veprave të poetit ose prekën çështje të veçanta të krijimtarisë së Naimit.⁹ Punime të kësaj natyre janë botuar edhe nga disa studjues në Kosovë; ato sjellin gjithashtu një kontribut për studimin e veprës së Naim Frashërit¹⁰.

Rëndësia e gjithë punimeve të kryera gjatë dhjetëvjeçarit që kaloi qëndron në faktin se ato zgjeruan rrethin e problemeve që dalin nga studimi i veprës së Naimit, ngritën teza të reja për çështje të ndryshme të krijimtarisë së tij ose zhvilluan më tej pikëpamje të shprehura më parë, bënë përpjekje për një analizë tërësore të veprave të veçanta ose të

7) *Historia e letërsisë shqipe* (Botim i USHT, Instituti i historisë dhe i gjuhësisë) T. 1959, f. 292-357.

8) Shih: Xholi Z., *Naim Frashëri mendimtar i shquar shqiptar*, «Buletin i USHT» (Seria shk. shoq.), 1959, 2, f. 3-42; Po ai, *Naim Frashëri — mendimtar, patriot, humanist i madh*, «Nëndori», 1960, 10, f. 135-159; Po ai, *Naim Frashëri — figurë e ndritur e Rilindjes sonë*, «Rruga e Partisë», 1962, 11, f. 90-102; Po ai, *Naim Frashëri* (Jeta dhe idetë) T. 1962, f. 77; Po ai, *Shënime rreth panteizmit të Naim Frashërit*, «Nëndori», 1965, 10, f. 87-117; etj.

9) Shih Gurakuqi M., *Disa anë dhe disa tipare të veprës letrare të Naim Frashërit* «Zëri i rinisë», 1965, 29 tetor; Kadare I., *Disa shënime rreth artit të Naimit*, «Drita» 1965, 24 tetor; Lezha N., *Disa çështje ideo-artistike në veprën «Histori e Skënderbeut» të Naim Frashërit*, «Bul. Shk. Inst. Ped. dyvjeçar, Shkodër», 1967, 6, 31-38; Lloshi Xh., *Mbi përdorimin leksiko-semantik të mbiemrit tek «Istori e Skënderbeut» e N. Frashërit*, (në librin «Konferenca II e studimeve albanologjike», vëll. III. T. 1970, f. 175-181); Shuteriqi Dh. S., *Lulet e verës — Parathënie e librit: N. Frashëri «Lulet e Verës»*, T. 1961, f. 3-8; Po ai, *Parathënje* [e librit N.H: Frashëri — *Vepra II*, T, 1967, f. 7-14]; etj.

10) Shih: Agani H., *Një vështrim lirikës së Naim Frashërit*, «Jeta e Re», Prishtinë, 1962, 1, f. 46-63; Qosja R., *Një kuptim i të bukurës dhe dashurisë* (në librin, «Episode letrare», Prishtinë, 1967, f. 5-19); Po ai, *Naim Frashëri ((1846-1900))* (në librin «Dialogje me shkrimtarët», Prishtinë, 1968, f. 39-93); Po ai, *Skënderbeu në vizionin e Naim Frashërit*, (në librin «Simpoziumi për Skënderbeun», botim i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Prishtinë, 1969, f. 337-346); Po ai, *Paralele ndërmjet letërsisë së Rilindjes kombëtare dhe romantizmit evropian; «Gjurmime albanologjike»*. Prishtinë, 1969, 2, f. 65-88; Kaleshi H., *Veprat turqisht dhe persisht të Naim Frashërit*. «Gjurmime albanologjike», 1970, 1-2, f. 143-153.

pikëpamjeve të tij filozofike e shoqërore dhe prekën problemin e kontributit të Naimit në fushën e mendimit pedagogjik shqiptar¹¹.

Fillimin e një faze të re në zhvillimin e studimeve tona historiko-letrare e shënuan dokumentat e fundit të partisë dhe fjalimet e shokut Enver për thellimin e revolucionit ideologjik e kultural në vendin tonë dhe revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës. Këta dokumenta hodhën një dritë të re edhe në kuptimin e epokës së Rilindjes dhe u dhanë mundësi studjuesve tanë të riformulojnë pikëpamje të reja për një varg çështjesh të zhvillimit letrar gjatë kësaj epoke. Duke ndihmuar për një vlerësim kritik dhe objektiv nga pikëpamja shkencore të traditës sonë letrare në tërësi, ato dhanë shkas të rimereshin probleme të tilla si ai i botëkuptimit të rilindasve dhe i kufizimeve të tij dhe të vihej studimi i tyre mbi një bazë më të shëndoshë metodologjike. Në këtë kuptim edhe studimet e ardhshme për veprën e Naim Frashërit do të ndihmojnë të ndriçohen në mënyrë më objektive vlerat e saj.

* * *

Rezultati më i rëndësishëm i studimeve tona të pasçlirimit për Naim Frashërin, si për gjithë trashëgimin tonë të së kaluarës, është zbatimi i metodologjisë marksiste në analizën e brendisë ideore dhe të vlerave artistike të veprës së tij, shpjegimi nga pikëpamja historiko-shoqërore i thelbit dhe i rëndësisë së saj progresive si dhe i kufizimeve që ajo objektivisht mbart.

Duke u mbështetur edhe në rezultatet që kish arritur në studimin e epokës së Rilindjes shkenca historike shqiptare, shkenca jonë për letërsinë e studjoi veprën e Naimit lidhur ngushtë me detyrat e mëdha kombëtare që shtronte koha, me luftën e masave për çlirim nga zgjedha e huaj, që përbën brendinë dhe tendencën më progresive të zhvillimit të tërë kësaj epoke të ndritur të historisë sonë. Mbi këtë bazë u zbulua vlera e vërtetë e veprës së poetit e cila buron prej faktit se ajo shprehu shqetësimet, aspiratat dhe dëshirat e flakta të shumicës dërmuese të popullit shqiptar për zhdukjen e zgjedhës së huaj, që ishte detyra më e rëndësishme historike dhe kërkesa më urgjente e kohës, pika ku konvergimin në çastin e dhënë interesat më imediate të klasave dhe shtresave të ndryshme të shoqërisë së atëhershme shqiptare.

Në përputhje me kuptimin marksist për origjinën dhe rolin e ideve në zhvillimin e shoqërisë dhe në luftë me konceptin idealist e antishkencor të filiacionit të ideve, mendimi politik filozofik e shoqëror i poetit u pa si produkt i zhvillimit të shoqërisë shqiptare të asaj epoke, lidhur ngushtë me proceset dhe ndryshimet social-ekonomike që ngjajnë në gjirin e saj. Në këtë mënyrë u shpjeguan drejt edhe shkaqet e lidhjeve dhe raporti i sistemit të pikëpamjeve të Naimit me iluminizmin francez dhe me rrymat e ndryshme të mendimit shoqëror e filozofik me të cilat poeti qe në kontakt.

Studimet tona për Naimin vunë në dukje meritën historike të poetit

11) Dedja B., *Ideali i Naim Frashërit për edukatën (Aspekte nga historia e pedagogjisë shqiptare)*, «Mësuesi», 1965, 29 janar; Xholi Z., *Naim Frashëri — pionier i mendimit pedagogjik të përparuar në Shqipëri*, «Mësuesi», 1970, 21 tetor etj.

frashërijot dhe të ideologëve të tjerë të Rilindjes të cilët u dhanë lëvizjeve spontane popullore të shqiptarëve kundër Turqisë një program të qartë nacional dhe përpunuan një botëkuptim të ri, ideologjinë e re kombëtare që printe drejt lirisë, dritës e përparimit, duke ia kundërvënë atë ideologjisë obskurantiste dhe antishqiptare të pushtuesit. Mbi këtë bazë është përcaktuar fryma popullore kombëtare dhe karakteri militant i poezisë së Naimit, si një nga tiparet e saj më të qenësishme.

Një tipar që shquan studimet tona për Naimin është përpjekja për ta parë në tërësi veprën e tij si një moment zhvillimi të një procesi të caktuar, si një hallkë që ruan lidhje me një traditë ekzistuese dhe që e mohon atë, si një themel që krijoi një traditë të re. Në këtë plan janë bërë përpjekje për të sqaruar marrëdhënjet e poezisë së Naimit me krijimin poetik të bejtexhinjve dhe është vënë në dukje fakti se, duke u nisur nga bejtexhinjtë, arti i Naimit, që shprehu idealet e lëvizjes kombëtare, ishte në thelb një mohim dialektik i asaj tradite që gjeti para tij.

Sadoqë nuk ka punime të veçanta për elementin e ri që solli Naimi në zhvillimin e letërsisë sonë, si në pikëpamje të brendisë po ashtu edhe të formës artistike, në studimet e këtyre dy dekadave ka përgjithësime dhe konstatime të sakta për rolin që lojti vepra e Naimit në themelimin e letërsisë sonë kombëtare dhe të gjuhës sonë letrare, për temat dhe motivet e reja që trajtoi ai, si krijues i poezisë së madhe të atdheut, i lirikës patriotike dhe filozofike (po të lihen mënjanë arbëreshët) si poet që bëri një hap drejt poemës epiko-heroike, si artist që zgjeroi tepër mundësitë e shprehjes artistike të poezisë sonë dhe pasuroi në shumë drejtime prozodinë shqiptare, si një nga inisiatorët e parë të rëndësishëm të letërsisë për fëmijë tek ne.

Duke pranuar faktin se me veprën e Naimit u krijua një traditë që u ndoq nga poetët që erdhën pas tij, në mjaft raste janë vënë re lidhjet e poezisë së Çajupit, Asdrenit e ndonjë tjetri me këtë traditë, megjithëse në tërësi tema «Naimi dhe poezia shqiptare e mëvonshme» është thuar se e paprekur nga studimet tona.

Në studimet e gjertanishme për Naimin më i përhapur është tipi i studimit sintetik, biografik dhe historiko-letrar në të njëjtën kohë si dhe i artikujve shkencorë për vepra të veçanta. Studimet krahasuese nuk ekzistojnë, megjithatë në raste të ndryshme janë hequr paralele midis poezisë së Naimit dhe letërsisë klasike greke, letërsive orientale apo romantizmit evropian, të cilat kanë vënë në dukje disa pika takimi dhe ndikime të pjesshme të këtyre letërsive në krijimin naimjan.

Vëmendjen e studimeve tona, sidomos në dekadën e fundit e kanë tërhequr problemet e botëkuptimit të Naimit, të karakterit dhe burimeve të panteizmit të tij si dhe aspektet e tjera që lidhen me bazën filozofike të botëkuptimit të poetit.

Pikëpamja që ka ekzistuar gjër vitet e fundit në tërë literaturën shkencore për Naimin pranon që pikënisja e botëkuptimit të poetit, zgjidhja që i jep ai problemit themelor të filozofisë, raportit midis qenjes dhe ndërgjegjes, është idealiste, por, sipas kësaj pikëpamjeje, Naimi merr udhën e materializmit kur pranon mundësitë e njohjes së botës materiale dhe del kundër agnosticizmit fetar e filozofik. Duke vënë drejt në dukje rolin historikisht progresiv që lojti njohja dhe propagandimi prej Naimit, në botimet për shkollat, i disa prej rezultateve të shkencave ekzakte të kohës, studjuesit e kanë interpretuar këtë si një provë të kalimit në materializëm dhe nënvizuan se pikëpamjet e tij filozofike

kanë ndihmuar shumë për formimin e një botëkuptimi materialist në lexuesit e veprave të poetit.

Kohët e fundit është shprehur mendimi se në thelb botëkuptimi i Naimit mbeti gjer në fund idealist dhe se pranimi i disa rezultateve të shkencës së kohës nuk preku aspak bazën e këtij botëkuptimi, në të cilën qëndron idea e ekzistencës së zotit dhe e pavdekësisë së shpirtit. Në të mirë të kësaj teze flet edhe fakti që krijimtaria e Naimit, e marrë në procesin kohor të zhvillimit të saj, nuk lë shteg për të parë ndonjë evolucion në botëkuptimin e tij drejt materializmit. Në studimet e gjertanishme ky fakt nuk është përfillur dhe vepra e fundit e poetit, «Qerbelaja» (1898) nuk është trajtuar nga kjo pikëpamje.

Nga rrethi i gjerë i problemeve ontologjike dhe gnoseologjike të filozofisë së Naimit studimet kanë ndriçuar një varg çështjesh dhe kanë arritur në disa konkluzione të cilat merren si argumenta për të provuar se tek ai ekziston një sistem filozofik kontradiktor, ku bashkëjetojnë pikëpamje sistemesh të kundërta filozofike.

Në qendër të studimeve për botëkuptimin e Naimit ka qenë problemi i panteizmit të tij. Duke e pranuar panteizmin si kredon filozofike të poetit dhe, duke e njohur atë si një moment përparimtar në sistemin e pikëpamjeve të tij për botën, për vetë faktin se i kundërvihej fesë zyrtare, islamizmit ortodoks, dhe lozte rol pozitiv në kuadrin e luftës që bënte populli shqiptar për të dalë «nga errësira mesjetare-feudale, imperialiste në dritë», studjuesit ndahen në kuptimin e thelbit, karakterit dhe burimeve teorike të panteizmit të Naimit.

Krahas mendimit më të përhapur dhe të shtjelluar në disa punime për thelbin materialist të panteizmit naimjan, në literaturën tonë shkencore është shtruar edhe teza se pikëpamja panteiste e Naimit për botën është idealiste. Kësaj teze i japin një bazë të qëndrueshme tërë studimet që kanë provuar se burimi teorik i panteizmit të Naimit nuk ka qenë panteizmi materialist evropjan i Rilindjes dhe i shekullit XVII, siç është pohuar në ndonjë rast, por doktrina idealiste, religjioze-mistike e sufizmit.

Duke u përpjekur për një vështrim tërësor të figurës së Naim Frashërit, studimet tona kanë ndriçuar edhe problemin e pikëpamjeve që kishte ai për shoqërinë, moralin dhe edukatën, por në ndriçimin e kësaj ane të botëkuptimit si dhe në përcaktimin e bazës së tij filozofike ka penguar prirja për ta zbukuruar dhe idealizuar figurën e Naimit, duke lënë në heshtje kufizimet ideore që janë shprehur në gjithë veprën e tij. Kjo prirje është shfaqur jo vetëm në përpjekjet për ta paraqitur botëkuptimin e poetit thujse materialist, duke e shpjeguar edhe interpretimin idealist-fetar të botës nga ana e tij, më tepër si një lëshim që i bëhej ambjentit anadollak se sa bindje të Naimit, por edhe në përpjekjet për të injoruar momentin klasor në interpretimin e anëve të tilla thelbësore të ideologjisë së poetit, si idea e humanizmit abstrakt mbiklasor, e harmonisë dhe e dashurisë së përgjithshme etj.

Një fushë e veçantë kërkimesh për Naim Frashërin do të ishte studimi i historisë së krijimit të veprave të tij, por mungesa e kërkimeve arkivale ka penguar fillimin e një pune të tillë, si dhe zbulimin e të dhënave të reja për jetën dhe veprmtarinë letrare, patriotike e shoqërore të poetit.

Gjatë dy dekadave e ca të ekzistencës së saj, shkenca shqiptare për letërsinë ka përballuar një varg problemesh komplekse që dalin nga studimi i jetës dhe veprës së Naim Frashërit. Ndriçimi i plotë tërësor dhe

objektiv nga pikëpamja shkencore i veprës së Naimit kërkohet që jo vetëm të sqarohen ato probleme që s'kanë marrë ende një zgjidhje përfundimtare, por të shtrohen edhe probleme të tjera, sqarimi shkencor i të cilave duhet të përbëjë drejtimet kryesore të studimeve të ardhshme në këtë fushë.

R é s u m é

LES ETUDES ACTUELLES ALBANAISES SUR NAIM FRASHËRI

Après avoir fait ressortir qu'avant le triomphe de la révolution populaire en Albanie, la figure de Naim Frashëri avait été éclairée à partir des positions du nationalisme bourgeois, de l'éclectisme philosophique et des conceptions subjectivistes-idéalistes des écoles esthético-formalistes et psychologiques, l'auteur fait remarquer que ce n'est que dans les études d'après la libération du pays, faites sur la base de la méthodologie marxiste, que la figure et l'oeuvre de Naim Frashëri prennent leur véritable dimension. Cette dimension est réalisée par une nouvelle interprétation dans le cadre de l'histoire de la littérature de la Renaissance nationale albanaise.

Réépillant les phases par lesquelles a passé l'étude scientifique de l'activité patriotique et littéraire de Naim Frashëri, l'auteur fait remarquer que les résultats obtenus dans la première phase ont été synthétisés dans le chapitre relatif de l'histoire de la littérature albanaise, parue en 1959, où l'oeuvre du poète a été considérée comme partie organique du processus historico-littéraire du temps et a été élucidée sous les nombreux aspects qui la composent. Des recherches ultérieures ont élargi et approfondi l'étude de quelques aspects particuliers de l'oeuvre de Naim, qui a permis de mettre au clair surtout les conceptions philosophiques de celui-ci.

Le résultat le plus important des études albanaises d'après la libération du pays sur Naim Frashëri est l'application de la méthodologie marxiste dans l'analyse du contenu idéologique et des valeurs artistiques de son oeuvre, l'explication au point de vue historico-social de l'essence et de sa portée progressive ainsi que des limitations qu'elle porte objectivement.

L'oeuvre de Naim Frashëri a été étudiée en lien étroit avec les grandes tâches nationales que soulevait l'époque où a vécu le poète, avec la lutte des masses pour la libération du joug étranger; elle a été vue, d'autre part, comme un jalon de développement d'un processus donné, comme un maillon qui garde des liens avec une tradition existante et qui la nie, comme un fondement qui a créé une nouvelle tradition.

Les études de ces deux ou trois dernières décennies, fait observer l'auteur, ont mis au clair le rôle qu'a joué l'oeuvre de Naim Frashëri dans la fondation de la littérature nationale albanaise, le nouvel élément qu'elle a apporté dans le développement et l'enrichissement idéologique et artistique de cette littérature.

Tendant leur effort pour un examen d'ensemble de la figure de Naim Frashëri, les études actuelles albanaises, conclut l'article, ont élucidé aussi la question de la conception philosophique de notre auteur, des points de vue qu'il avait sur la société, la morale et l'éducation.

